

Gazetari shqiptar mes stadardeve profesionale dhe presioneve të jashtme

*Ramadan Çipuri**

Abstrakt

Jo vetëm në Shqipëri, por edhe më gjerë, liria e informimit është e garantuar me Kushtetutë, por megjithatë e vazhdimisht ajo mbetet një çështje shumë e debatueshme. Mediet, e kryesisht punonjësit e tyre, përgjithësisht, për arsye të ndryshme nuk u shkojnë deri në fund kërkesave të tyre. Trysnia mbi gazetarin sa vjen e shtohet nga politika, pronarët mediatikë, reklmadhënësit etj. Ky punim do të analizojë tre dimensione kryesore që kanë të bëjnë me lirinë dhe statusin e gazetarëve në mediet shqiptare, me dualitetin që i shoqëron mes ushtrimit të stadardeve profesionale dhe trysnive të ardhura nga jashtë.

Së pari, punimi do të hedhë dritë mbi rëndësinë e statusit të gazetarit. Problemet kryesore që gazetarët shqiptarë hasin në një treg mediatik ku profesioni vijon të jetë i parregulluar. Së dyti, punimi do të vlerësojë burimet kryesore që ndikojnë në lirinë e ushtrimit të profesionit nga gazetarët shqiptarë. Së treti, varësisht nga kushtet e mësipërme, studimi do të analizoje varësinë (gjendjen) ekonomike të gazetarëve shqiptarë dhe pasojat e saj.

Në fund të studimit, bazuar në analizën shkak-pasojë, synohet të zbardhen problemet kryesore që kanë të bëjnë me komunitetin e gazetarëve shqiptarë.

Fjalët kyçe: *statusi i gazetarëve, profesion i rregulluar, censura, vetëcensura, kriza ekonomike*

Cili është statusi aktual i gazetarit në Shqipëri?

Për të përcaktuar statusin aktual të gazetarit në Shqipëri mjafton të shihet se në asnjë prej dokumentave ligjorë që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë nuk përmendet koncepti gazetar. Edhe pse në Shqipëri ekzistojnë shumë organizata gazetarësh, ato shfaqen të fragmentarizuara e jo të gjitha aktive në

* Ramadan Çipuri, PhD Cand., Universiteti Hëna e Plotë Bedër, Tiranë. Email: rcipuri@beder.edu.al

përfaqësimin e komunitetit. Deri në vitin 2007, nismat ligjore nga ana e gazetarëve për përmirësime të legjislacionit dhe statusit social e ekonomik të tyre thuajse kanë munguar tërësisht.

Rekrutimet e gazetarëve në punë vazhdojnë të kryhen sipas preferencave të administratorit apo pronarit të medias që në shumicën e mediave është person ekstra-profesional, që nuk ka lidhje me gazetarinë dhe me përvojat në këtë sektor veç me përfitimet politike a ekonomike për të përdorur median e tij si armë ose mburojë të pushtetit. Si rezultat, asnjë prej editorëve nuk ushtron të drejtën e ngritjes së stafit dhe të rekrutimit të gazetarëve për të pasur një ekip sipas parimeve të kualifikimit, përvojës dhe arsimit. Madje, sipas kryetarit të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, Aleksandër Çipa, në mbi 70 për qind të mediave gjatë aktit të rekrutimit, nga zyrat e burimeve njerëzore nuk kërkohet as dokumentacioni për dosjen personale të gazetarit. Pothuajse në të gjitha mediat mungojnë gjithashtu detajet e përshkrimit të punës së punonjësve të tyre, etj.

Në redaksi largimet nga puna të gazetarëve janë të shpeshta dhe pa përfillur të drejtën apo prezumimin e fajit nga ana e gazetarit. Vetëm pas vitit 2006 në Gjykatën e Tiranës nisën procese gjyqësore për rastet arbitrare të largimeve nga puna të gazetarëve nga ana e administratorëve të medias. Para kësaj periudhe rastet numërohen me gishta.

Pas vitit 2011 skena mediatike e vendit merr zhvillim intensiv sidomos në fushën e mediave audiovizive. Në këtë skenë sipas statistikave të UGSH janë të punësuar rreth 5000 punonjës, prej të cilëve rreth 2000 janë gazetarë dhe mes të cilëve rreth 1350 gazetarë profesionistë. Në këtë periudhë në gjashtë gjykata vendore zhvillohen mbi 137 procese gjyqësore të hapura nga gazetarët ndaj administratorëve të medias. Sipas të dhënave të raportuara nga UGSH përmes një anketimi me 500 gazetarë, rezulton se një ndër shkaqet më të rëndësishëm që ka detyruar gazetarët t'u drejtohen gjykatave është largimi i pajustificuar nga puna, duke vijuar më tej me parregullsitë me pagesat në punën e bërë, shfrytëzimi nga ana e punëdhënësit apo

konfliktet e krijuara me të në lidhje me çështje politike si dhe shfrytëzimi i të drejtave të autorit.¹

Përmes të njëjtit studim vihet re se në vitin 65 % e gazetarëve deklarojnë se ka një ndryshim të dukshëm midis numrit të viteve që ata kanë punuar si gazetarë pranë një enti mediatik dhe numrit të viteve të punës gjatë së cilës kanë qenë të pajisur me një kontratë pune. “Në kontrast me këtë, 35 % e totalit të gazetarëve të anketuar kanë pohuar se gjatë viteve në të cilat kanë ushtruar profesionin si gazetarë kanë qenë të pajisur me kontratë pune.”²

Problemi i punësimit në kushte kontraktuale ka qenë akoma e më theksuar gjatë viteve '90. “Nëse do t'i referoheshim përqindjes reale, në etapën e parë të paskomunizmit, 1992-1997, niveli i punonjësve pa të drejta shoqërore ishte në rreth 95%. [...]Në etapën e dytë, 1997-2003 treguesi shënonte shifrën 90%.Në fazën e tret nga 2003 deri në 2006, treguesi zbriti në 75%.Gjatë viteve 2006-2009 ky numër zbriti midis nivelit 45-60%, ndërkohë që përqindja e gazetarëve të patrajtuar nëpër rrethe është është shumë më e madhe.”³ Referuar shtypit të shkruar të viteve 2000, rezultonte se vetëm 10% e gazetarëve që e ushtronin profesionin e tyre në kryeqytet ishin të siguruar, ndërsa pjesa tjetër ushtrohej në të zezë. Po ashtu 95% e gazetarëve që shërbenin në prefekturat jashtë Tiranës vazhdonin të mos përfitonin asnjë lloj mbrojtjeje sociale.

Shumica e gazetarëve që veprojnë dhe punojnë në mediat shqiptare kanë përfituar kartën e anëtarësisë në Federatën Botërore të Gazetarëve, kartë e shpërndarë nga dy organizatat që në periudha të ndryshme kanë pasur statusin e anëtares me të drejta të plota në këtë federatë. Së pari “Lidhja e Gazetarëve Shqiptarë” me kryetar Ylli Rakipin dhe më pas “Shoqata e Gazetarëve Profesionistë” me kryetar Armand Shkullakun.Të dyja këto shoqata nuk e kanë më këtë status për shkak të mosderdhjes së kontributeve financiare vjetore si

¹UGSH, Friedrich Ebert Stiftung, and OSBE. *Praktikat informale të punësimit në median shqiptare*. Tiranë: OSBE, 2012. F.26-27

²Po aty. F.21

³UGSH. *Monografi*. Tiranë: WESO, 2010:11

kuotacione. Kjo ka bërë të mundur që tashmë asnjë prej gazetarëve të mos ta ketë mundësinë e ripërsëritjes së kësaj karte.

Kushtet që vështirësojnë statusin e gazetarëve

Niveli i lirisë së shprehjes në Shqipëri

Ushtrimi i profesionit të gazetarëve në Shqipëri është i ndikuar nga një sërë faktorësh që kufizojnë ose zgjerojnë kufirin e lirisë së shprehjes dhe zhvillimit të profesionalizimit të medias. Pyetja që Abdi Baleta drejton që në qershor të vitit 2003 se *'Kush do ta frenojë ofensivën që po i zë frymën lirisë së shtypit?!'*,⁴ fatkeqësisht kur kanë kaluar plot 12 vjet, edhe sot e kësaj dite, mbetet pa një përgjigje. "Liria e medias i mban shoqëritë dhe ekonomitë të gjalla, energjike dhe të shëndetshme. Kur ndërpritet rrjedha e lirë e lajmeve dhe informacionit, individët vuajnë. Shoqëritë vuajnë. Ekonomitë vuajnë"⁵.

Organizata ndërkombëtare 'Freedom House' në raportin e përvitshëm mbi lirinë e medias, për të disatin vit rradhazi, në maj të 2015-s radhiti Shqipërinë në mesin e vendeve pjesërisht të lira. Shqipëria nuk arriti të kalonte mbi disa vende të rajonit si Serbia, Mali i Zi e Kroacia. Elen Aghekyan, eksperte në organizatë, nënvizon se media në Shqipëri është larg pavarësisë së vërtetë. "Bizneset e mëdha kontrollojnë tregun e medias, i cili është shumë i vogël."⁶, deklaroi ajo.

Table 1, Raport i Freedom House mbi lirinë e medias në Shqipëri

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Independent Media	4.00	3.75	4.00	3.75	3.75	3.75	3.75	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00	4.00

⁴Baleta, Abdi. "Kush do ta frenojë ofensivën që po i zë frymën lirisë së shtypit?" *Rimëkëmbja*, 2003.

⁵Arvizu, Aleksander. "Pse liria e medias i bën shoqëritë më të shëndetshme." *Gazeta Shekulli*, 2012: 9.

⁶Shqip. «Freedom House: Liria e medias në Shqipëri e pjesshme.» *Gazeta Shqip*, 2015: 5.

Në raportin “Indeksi i Lirisë së Shtypit në Botë 2015” të hartuar nga organizata ndërkombëtare “Reporterët pa kufi”, me seli në Paris, Shqipëria rezulton të ketë bërë progres sa i përket lirisë së mediave. Në këtë raport, Shqipëria është renditur në vendin e 82-të nga 180 vende të ndryshme duke shënuar një ngritje në krahasim me një vit më parë ku zinte vendin e 85.

Table 2 Indeksi i Lirisë së Shtypit në Shqipëri sipas "Reporterëve pa kufi"

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2019	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Renditja	34 / 158	50 / 158	62 / 161	80 / 161	87 / 164	79 / 168	88 / 170	80 / 173	-	102 / 178	102 / 178	85 / 180	82 / 180

Në mënyrë të përvitshme, e së fundi në Progres raportin e vitit 2014 për Shqipërinë, Komisioni Evropian (KE) vijon të jetë kritik ndaj lirisë së shprehjes në vend. KE vlerëson se “Gazetarët duhet të mbrohen nga largimi arbitrar, me qëllim që të parandalohet vetëcensurimi.”⁷ Sipas KE-së, media vazhdon të përdoret si mjet për të promovuar interesa politike dhe ekonomike private.

Kritike ndaj lirisë së shprehjes në Shqipëri ka qenë edhe IREX. Në raportin e vitit 2012 mbi “Indeksin e Qëndrueshmërisë së Medias”, IREX theksoi se në Shqipëri “një numër në rritje i mediave i janë nënshtruar varësisë politike, kryesisht të partisë në pushtet. Tani media e pavarur dhe gazetarët janë një specie e rrallë, pranë zhdukjes” (IREX 2012), thekson IREX.

Tipare të gazetarisë shqiptare

Për të analizuar statusin e gazetarit duhet më parë të shtrojmë pyetjen se ‘Kush janë gazetarë? Nga ç’formim universitar / profesional vijnë ata?’. Gjithësesi duhet pranuar se gazetaria është një profesion që pranon brenda saj edhe specialistë që vijnë nga fusha të tjera : ekonomistë,

⁷KE.Progres Raport 2014 për Shqipërinë.Vjetor, Bruksel:Komisioni Evropian,2014:54

juristë, studiues të shkencave politike e marrëdhënieve ndërkombëtare, specialistë të gjuhësisë etj.

Studimet tregojnë se “në total 53% e gazetarëve kanë një diplomë të profilizuar në gazetari-komunikim dhe 47 % e tyre nuk janë të diplomuar në shkencat e komunikimit. Në lidhje me studimet e ciklit të dytë, studimet tregojnë se 65% e gazetarëve nuk kanë kryer një master, ndërsa 35% zotërojnë diplomë në studime më të profilizuara. Ndërkohë, rezulton se rreth 80% e tyre kanë marrë pjesë në stazhe apo kurse profesionale mbi gazetarinë”⁸. Por, në një realitet të funksionimit të medieve shqiptare, të pyetur në lidhje me këtë çështje, 6 përfaqësues nga zyrat e burimeve njerëzore në këto medime nuk pranojnë të përgjigjen qoftë për numrin e vërtetë të gazetarëve qoftë edhe për fushat nga ku ata vijnë. Kjo, për arsye të ndryshme, si nga mungesa e aplikimit të procedurave ligjore për punësimet e reja, po ashtu edhe nga një numër i konsiderueshëm i gazetarëve që punojnë për redaksitë e tyre, por që nuk gëzojnë marrëdhënie kontraktuale me punëdhënësit.

Nga ana tjetër, për vite me rradhë shtypi është kritikuar për qëndrimin ndaj lajmit, për dyzimet që tregon, teprinë me lajmet joshëse e rënien preh ndaj presioneve financiare. Të tjera ankesa vijnë për pasaktësi, mungesë etike e doza të larta nacionalizmi. Studiuesi amerikan Jerry Shan Shiong Huang (Xheri Shan Shiong Huang) vlerëson si arsye kryesore të gjithë këtij gjykimi mënyrën e përzgjedhjes dhe trajnimit të vazhdueshëm të gazetarëve. “Me një gazetar apo redaktor i cili mund të jetë vetëm një i diplomuar nga një shkollë gazetarie e pa zhvillim të mëtejshëm, përgjegjësia e të cilit është vetëm llogaridhënie ndaj shefit të tij e jo ndaj publikut, arritja e standardeve të përsosmërisë është e pamundur.”⁹. Në rastin shqiptar, kjo ndodh shpesh pasi edhe rekrutimet bëhen kryesisht sipas dëshirës së pronarëve, të cilët në të shumtën e rasteve vijnë nga jashtë

⁸Skana,Pranvera.*Statusi socio-profesional i gazetarit shqiptar*. Tiranë:Punim doktoral në Universitetin e Tiranës, 2014:121

⁹Huang, Jerry Shan Shiong. *Mass Communication Research*. n.d. http://mcr.nccu.edu.tw/issueArticle.asp?P_No=48&CA_ID=698 (vizituar më Prill 20, 2015)F.13

profesionit dhe e përdorin atë si një mjet mbështetës për interesat e tyre, në mbështetje të bizneseve të tjera përkrah saj.

Kjo mënyrë rekrutimi dhe përzgjedhjeje ka çuar në një ulje të ndjeshme të numrit të gazetarëve profesionistë që e mendojnë të bëjnë karrierë në këtë profesion, si dhe largimin e tyre drejt profesioneve të ngjashme si zëdhënës të zyrave për shtyp, zyra të marrëdhënieve me publikun, marketing etj.

Largimin nga gazetaria aktive, Nimet Isufi, ish-gazetar në disa të përditshme të Tiranës thotë se: “Shkaqet kryesore lidhen drejtpërdrejtë me statusin social të gazetarëve, pagesat e ulëta, vonesat e vazhdueshme të rrogave, trajtimi aspak profesional, puna në kushte jo të mira etj.”¹⁰. Alban Tartari, ish gazetar terreni në Televizionin Publik Shqiptar (TVSH) shprehet se “shkaku kryesor i largimit nga gazetaria aktive për të kaluar në sektorin e marrëdhënieve publike ka qenë trajtimi financiar.” Të njëjtat arsye largimi nga gazetaria aktive i pohon edhe ish-gazetari i gazetës Standard, TV Top-Channel dhe TV Vizion Plus, Erlis Çela, i cili thekson se “pronarët e mediave tentojnë të zëvendësojnë gazetarët e karrierës, pritshmëritë financiare të të cilëve mund të jenë të larta, me gazetarë të rinj, shpesh të porsa diplomuar.”¹¹

Në rastin shqiptar, sipas një anketimi të organizuar nga ISHM, rezulton se ndërhyrja në brendinë e lajmit është shumë e lartë, gjë kjo që fal veçorive të përmendura më sipër ndikon edhe në imazhin e gazetarit dhe profesionit. Pyetjes se “A kanë patur ndërhyrje për të ndryshuar shkrimin / kronikën?”, 89 nga 123 gazetarë të pyetur, pra rreth 72% përqind e tyre pohojnë se kanë patur diçka të tillë.¹²

Gazetarë të intervistuar në lidhje me këtë çështje, shprehen se përkrah faktorëve të tjerë si politika, reklamdhënësit etj, pronarët e mediave janë ata që kërkojnë të kenë edhe ndërhyrjen më të madhe në punën e gazetarit.

¹⁰Isufi, Nimet, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (5 shtator,2013).

¹¹ Çela, Erlis, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi në redaksi i gazetarëve* (2 shtator, 2013).

¹²ISHM. *Vetëcensura dhe censura e butë në median shqiptare*. Vjetor, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2013:12

Ish kryeredaktor në TV Klan, Arben Vata shprehet se “pronarët e medias i shfrytëzojnë gazetarët për qëllimet e tyre ekonomike, por si gjithnjë në dëm të misionit të mediave”¹³.Më radikale shprehet gazetarja e Gazetës Tema, Lindita Çela, aktualisht në TV Ora Neës, e cila mendon se “në Shqipëri gjatë viteve të fundit nuk ka media, në kuptimin parësor të saj. Si rrjedhojë nuk ka as gazetarë, ose së paku kanë pushuar së funksionuari.”¹⁴

Përveç ndalimit të drejtpërdrejtë dhe të hapur për lajme të caktuara, “pjesa dërrmuese e gazetarëve pohojnë se kanë pasur sugjerime apo urdhra të drejtpërdrejta për të shkruar lajme të caktuara, përkatësisht 106 nga 123 të anketuar, pra 86% e tyre.”¹⁵

Të pyetur në lidhje me këtë çështje, gazetarë që punojnë në media të ndryshme vendase dhe të huaja shprehin qëndrime të ndryshme. Për gazetarët e *DË* në Tiranë, Arben Muka¹⁶, atë të *Anadolu Ajans*, Aida Vishko¹⁷, korrespondentin e kanalit publik turk TRT, Fatjon Prroni¹⁸, kjo gjë nuk u ka ndodhur.

Denis Minga¹⁹, ish kryeredaktor në Neës 24 TV pohon se “ka ndodhur disa herë për shkak të linjës dhe interesave të pronarit”.Gazetar dhe moderator i njohur në disa televizione, Armir Shkurti²⁰ thotë “Po.Më ka ndodhur që në fillimet e mia (1992) dhe ka qenë shoqëruese gjatë gjithë karrierës.” Gazetarja e Neës 24 TV Anisa

¹³Vata, Arben, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensura në redaksi e gazetarit* (8 shtator, 2013).

¹⁴Çela, Lindita, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensura në redaksi e gazetarëve* (5 korrik, 2013).

¹⁵ISHM. *Vetëcensura dhe censura e butë në median shqiptare*. Vjetor, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2013:13

¹⁶Muka, Arben, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (11 shtator, 2013).

¹⁷Vishko, Aida, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (9 shtator, 2013).

¹⁸Prroni, Fatjon, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (12 shtator, 2013).

¹⁹Minga, Denis, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (Gusht 23, 2013).

²⁰Shkurti, Armir, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (24 Gusht 2013).

Ymeri²¹ thekson se “ka pasur më shumë se një rast dhe që ky është një fenomen që përsëritet shpesh.” Kryeredaktori i Vizion Plus TV Roland Zili²², pohon gjithashtu: “Sigurisht, kjo ka ndodhur. Ai gazetar që e mohon një fakt të tillë, thjesht gënjen.” Në këtë këndvështrim, kur flet për gjendjen e medias në ditët e sotme, Remzi Lani e përshkruan atë me dy fjalë: ripolitizim dhe klientelizëm“Ripolitizimi dhe klientelizmi i medias aktualisht janë ndër problemet më serioze me të cilat ajo përballet”²³

Hapësira ligjore në mbështetje të shtypit

Niveli i lirisë së fjalës dhe hapësirave se deri ku mediat mund të veprojnë përbëjnë një element të rëndësishëm për natyrën e statusit të gazetarit. Në një pamje të parë duket se Shqipëria ka një shtyp të lirë e të pavarur. Por, nëse do të analizohen hapësirat ligjore vihet re se liria e medias në Shqipëri është e kufizuar dhe kushtëzuar nda disa faktorë.

Në Shqipëri, deri në vitin 1993 nuk ka patur një ligj për shtypin e shkruar. Ishte kjo një karakteristikë e sistemeve moniste ku ligjet janë formale edhe kur ekzistojnë. Sot, në aspektin ligjor, janë disa ligje që tentojnë të rregullojnë lirinë e shprehjes dhe organizimin e medias në përgjithësi.

Së pari, liria e shprehjes garantohet në Kushtetutën e RSH, neni 22 i saj ku thuhet : “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.”

²¹Ymeri, Anisa, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensura e gazetarëve në redaksi* (2 shtator, 2013).

²²Zili, Roland, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (19 gusht, 2013).

²³Lani, Remzi. *Gazetaria profesionale dhe vetë-rregullimi : Media e Ballkanit, Lost in Transition?* Tiranë: Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, 2011:41

Së dyti, media e shkruar në Shqipëri rregullohet nga “Ligji për Shtypin” nr.8239, i miratuar në vitin 1997 si amendament i “Ligjit për Shtypin” me nr.7756 të miratuar në vitin 1993. Me ndryshimet e vitit 1997, ligji i ri përmban vetëm një rregull të përgjithshëm, ku thuhet “Shtypit është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj.”²⁴

Një tjetër hapësirë legjislative, media elektronike në Shqipëri për një kohë të gjatë është rregulluar me anë të ligjit Nr.8410 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat”, i cili pas 6 amendimesh u zëvendësua me ligjin nr.97 në vitin 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Në raportin vjetor të saj, OSBE u shfaq kritike ndaj këtij ligji duke theksuar se me përmes tij, transmetuesit publik rrezikojnë të bëhen vegla politike të shumicës qeverisëse.²⁵

Dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerje ka qenë një tjetër debat i gjatë politik gjatë fundit të viteve 2000 e në vazhdim. Në vitin 2012 nga disa ndryshime në kodin penal u hoq dënimi me burg për rastet e fyerjes dhe shpifjes.

Por, nga ana tjetër, masat e marra duket se kanë qenë të pamjaftueshme për të përmbushur pritshmëritë e Komisionit Evropian (KE), i cili në progres raportin e vitit 2013 për Shqipërinë theksoi se “Hapa të mëtejshëm nevojiten për dekriminalizimin e plotë të shpifjes. Ndërhyrja në media nga interesat politike dhe ekonomike duhet të jetë e kufizuar.”²⁶

Punonjësit e medias, ashtu si edhe çdo qytetar tjetër sigurojnë të drejtën e aksesit në dokumente publike edhe përmes ligjit “Për të drejtën e informimit”, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, si dhe ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së tyre.” Deri kur u miratua ligji i mësipërm, e drejta për informim rregullohej nga ligji nr 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën për informimin për dokumentat zyrtare”. Duke qenë se

²⁴Ligji për shtypin. Nr. 8239 (3 Shtator 1997). Neni 1.

²⁵OSBE. Raport përpara Këshillit të Përhershëm nga Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Vjetor, Tiranë: OSBE, 2013:9

²⁶KE. Progres Raporti 2013 për Shqipërinë. Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore për periudhën 2013-2014, Bruksel: Komisioni Evropian, 2013.

ndryshimet e bëra në ligj ishin të shumta, jo vetëm teknike, por edhe në përmbajtje, Këshilli i Ministrave solli një ligj të ri.

Kodi zgjedhor përbën një tjetër rregullator për mediat në mbulimin e periudhave para dhe paszgjedhore. Gjatë fushatës zgjedhore, radiotelevizioni publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara dhe të KQZ-së për të bërë fushatë, e cila ndahet sipas rregullave të caktuara. Për mediumet private, ligji parashikon se pasqyrimi i fushatës zgjedhore bëhet vetëm në edicionet e zakonshme dhe të posaçme informative.

Në Shqipëri që nga viti 1996 ekziston edhe Kodi i Gazetarit. Por, pavarësisht ekzistencës së tij, ai nuk njihet dhe nuk zbatohet. Mos zbatimi i tij vjen jo vetëm nga mosnjohja, por edhe nga mungesa e mekanizmave detyrues për zbatimin e këtij Kodi.

Një çështje problem për median shqiptare mbetet edhe mungesa e mekanizmave rregullues e vetërregullues, të njohur në median botërore siç është edhe Urdhëri i Gazetarit, i cili do të ndihmonte ndër të tjera për të venë mbi baza ligjore e kontraktuale aktivitetin e gazetarit, por edhe aktivitetin e medias në tërësi.

Tentativat e qeverisë shqiptare për një ligj që do të rregullonte pozicionin e gazetarit në vitin 2003, u përballën me reagimin e ndërkombëtarëve. ARTIKULLI 19 kritikonte me idenë "Ligji i ndalonte botuesit të punësonin gazetarë që nuk ishin regjistruar në Urdhër dhe kërkonte krijimin e një Regjistri të Gazetarëve, në të cilin duhet të regjistroheshin të gjithë gazetarët profesionistë."²⁷

Shoqatat e gazetarëve

Sipas një dokumenti të lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të siguruar nga Gjykatata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi listën e organizatave jofitimprurëse që operojnë në sektorin e medias²⁸, rezulton se në Shqipëri ka 64 shoqata gazetarësh, numër shumë i

²⁷OSBE. Janar 2004. <http://www.osce.org/sq/fom/34014?download=true> (vizituar më 3 maj, 2015).

²⁸*Propozim për anëtarë të Bordit të Monitorimit të Medias*. Nr. 1795 Prot. (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 23 shkurt, 2015).

madh ky për një komunitet të vogël profesionistësh në këtë fushë. Pavarësisht ekzistencës së kaq shumë grupimeve të ndryshme, gazetarët shqiptarë nuk kanë arritur të organizohen mes tyre dhe të kërkojnë të drejtat për një profesion të rregulluar. Problem është se asnjëra nga këto shoqata nuk ka arritur të institucionalizojë mbrojtjen reale të gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias prej punëdhënësve. “Kjo vjen edhe nga fakti se shumica e drejtuesve të këtyre shoqatave të gazetarëve janë pronarë apo bashkëpronarë të mediave”.²⁹

Ndërkohë, përballë një inflacioni të tillë shoqatash, vetëm disa prej tyre kanë qenë aktive gjatë dy dekadave të fundit. Ato janë “Lidhja e gazetarëve të Shqipërisë” ,themeluar në vitin 1993; “Shoqata e gazetarëve profesionistë të Shqipërisë”;; “Forumi i mediave të lira”; “Shoqata për median vizive”; Unioni i Gazetarëve Shqiptarë; “Shoqata e gazetarëve për drejtësi”, nën drejtimin e Kristina Fidhit e cila u themelua në vitin 2012. Aktiv është gjithashtu edhe “Instituti Shqiptar i Medias” (ISHM), i cili u themelua në vitin 1995 me mbështetjen e fondeve të ofruara nga DANIDA dhe *Shkolla Daneze e Gazetarisë*.

Kushtet financiare të gazetarëve shqiptarë

Kushtet financiare të gazetarëve shqiptarë vijnë të jenë në gjendje të mjerueshme. Sipas statistikave të bëra publike nga UGSH, bilanci i informalitetit në media për vitin 2015 është alarmant: Në 19 gazeta, në 62 televizione, në 63 radio dhe në 200 faqe *ëeb* (pra në 85% e mediave të vendit) gazetarët ose nuk janë paguar në kohë, ose nuk janë paguar fare.

Të kontaktuar në lidhje me këtë çështje, gazetarët nuk ngurojnë të shprehin pakënaqësitë që kanë, por kur u kërkohet të citohen si burim, ata janë të rezervuar. Kjo vjen si shkak i brishtësisë që sektori mediatik shfaq. Si rrallë herë më parë, në mënyrë publike erdhi edhe reagimi i gazetares së ABC News, Alma Çupi, e cila denoncoi vonesën

²⁹Londo, Ilda. *Legislation on Media ownership*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2004.

prej dy muajsh në marrjen e pagës së saj.³⁰Por, edhe në këtë rast, interesant mbetet fakti se vetëm rreth dy orë pasi ajo e kishte shtuar këtë status e që u përhap menjëherë në disa faqe online, gazetarja e fshiu nga profil i saj.

Sipas kreut të UGSH-së Aleksandër Çipa, në 23 gazetat e përditshme socio-politike të vendit vetëm në 4 prej tyre respektohen dhënia e pagave korrekte në kohë dhe ato janë Panorama, Gazeta Shqiptare, Shqiptarja.com, Shqip. Në 72 televizionet e vendit, të listuar sipas Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA), vetëm në 10 prej tyre nuk ka vonesa të pagave dhe detyrimeve financiare ndaj punonjësve, të cilat janë RTVSH, Top Channel, Neës 24, A1 Report, Klan, dhe disa televizione lokale. Në 71 radiot, 63 prej tyre janë në riciklim vonesash të pagave në mënyrën më arbitrare të cilat nisin nga një muaj e shkojnë deri në pesë muaj. Të njëjtën gjendje po ndjek edhe media më e re, ajo *online*. Nga 250 ëeb-e dhe gazeta online të celura përgjatë periudhës 2014 e gjer më sot, në të cilat na rezulton të jenë punësuar mbi 320 gazetarë, vetëm në 50 prej tyre ka një sistem modest pagesash, ndërsa në 200 prej tyre ka një realitet informal të tmerrshëm.³¹

Por, deklaratat për situatën reale të medias në Shqipëri duket se nuk u shoqëruan me masa konkrete pasi gjithçka vazhdoi të mbesë si më parë në amullinë e vet, “një gazetari në stanjacion”, siç e përcaktonte këtë realitet DW, në 3 maj 2016. Teksa pagat e gazetarëve në redaksi vijnë të jenë në nivelë të ulëta, vihet re një disnivel midis shumave monetare që u jepen analistëve e opinionistëve të ftuar në studio apo atyre që shkruajnë nëpër gazeta e faqe interneti, me atë që përfitojnë reporterët e terrenit. Në korrik të vitit 2011, disa gazeta shqiptare publikuan emrat e gazetarëve që paguheshin më shumë, pagat e të cilëve në varësi të angazhimit vijonin nga 150 mijë lekë deri në 3 milion lekë.³² Në këtë listë bënin pjesë emra të njohur të gazetarisë

³⁰Tema. «Gazetarja e ABC News denoncon televizionin e vet: kemi dy muaj pa marrë rrogat.» *Gazeta tema*, 04 Maj 2015: 10.

³¹Deklaratë e UGSH. (3 maj, 2015).

³²Mane, Bledi. *Gazeta Tema*. 16 Korrik 2011.

<http://www.gazetatema.net/ëeb/2011/07/16/15-gazetaret-me-me-influence-te-shqiperise-dhe-pagat-e-tyre/> (vizituar më Maj 04, 2015).

shqiptare si Blendi Fezviu, Arjan Çani, Andi Bushati, Artur Zheji, Sokol Balla, Ilva Tare etj.

Faktin e disnivelit midis opinionistëve dhe gazetarëve të redaksisë e pohon edhe kryeredaktori i një portali online, i cili teksa nuk pranon të identifikohet, shprehet se ka një pabarazi midis asaj që u japim gazetarëve dhe asaj që ndajmë për opinionistët. Këta të fundit, janë emra të njohur dhe për një analizë të thjeshtë i paguajmë së paku 10 mijë lekë. Ndërkohë, sipas tij, për gazetarët që punojnë së paku 8 orë në ditë, nuk mund të sigurojmë paga më të larta se 30 mijë lekë në muaj.

Përfundime

Të dhënat e kësaj tabloje e cila përgjithësisht nuk ndryshon thelbin e përmbajtjes së vet të padrejtësisë sociale mbi gazetarët, mbesin problematike dhe një arsye e madhe për atë që mund të konsiderohet “censura që buron nga brenda mediave” për shkak të rrethanave informale të të punësuarit të gazetarëve. Në mungesë të një ligji për median, në mungesë të dokumentave të tjerë ligjor që rregullojnë raportet e punës së gazetarit, në mungesë të një tregu mediatik real, duhet theksuar se kjo lloj censure sjell një “status vetëcensurimi” që është një kërcënim real edhe për vetë lirinë e shprehjes .

Të gjitha përpjekjet për t’a ndryshuar këtë status vetëcensurimi kanë dështuar në mungesë të një solidariteti unitar të komunitetit të gazetarëve dhe si rezultat i një “vullneti” të pushtetit për të mbajtur në stanjacion gjendjen aktuale si një përpjekje për të mbajtur gjithçka nën kontroll. Në këtë qark të mbyllur interesash - pronarë, pushtet, politikë, financë e benefitesh të tjera herë herë edhe okulte, organizatat nuk ia kanë dalë të bëhen bashkë për të arritur ndonjë rezultat konkret në ndryshimin e legjislacionit dhe sidomos në implementimin e dy kontratave tip të punësimit, asaj kolektive dhe individuale.

Bibliography

Andoni, Ben. Intervistuar nga Ani Ruci. *Shqipëria me gazetari në stanjacion* (3 maj, 2015).

Arvizu, Aleksander. "Pse liria e medias i bën shoqëritë më të shëndetshme." *Gazeta Shekulli*, 2012: 9.

Baleta, Abdi. "Kush do ta frenojë ofensivën që po i zë frymën lirisë së shtypit?" *Rimëkëmbja*, 2003.

Baze, Mero. «Të bëjmë një ligj për lirinë e shtypit.» *Gazeta Tema*, 2015.

Bollino, Carlo. «Fillon lëkundja.» *Shqiptarja.com*, 04.05.2015: 8.

Çela, Erlis, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi në redaksi i gazetarëve* (2 shtator, 2013).

Çela, Lindita, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensura në redaksi e gazetarëve* (5 korrik, 2013).

Çipa, Aleksandër, intervistë nga Ramadan Çipuri. Publikimi i statistikave mbi mediat që vonojnë pagat e gazetarëve (4 maj, 2015).

Çipa, Aleksandër, i intervistë nga Ramadan Çipuri. *Statusi i gazetarit shqiptar* (20 prill, 2015).

Deklaratë e UGSH. (3 maj, 2015).

Dervishi, Lutfi. «Kodi i etikës – rregullatori i munguar i mediave shqiptare.» *Shqiptarja.com*, 22.01.2013: 9.

Duran, Pascal. *Media et censure, Figures de l'orthodoxie, coll, sociopolis*. Paris, 2004.

Freedom_House. *Nations in Transit 2014 Albania*. Raort Vjetor, Freedom House, 2014.

Fuga, Artan. *Media, politika, shoqëria (1990-200)*. Tiranë: Botimet Dudaj, 2008.

Hoxha, Arsen, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (22 gusht, 2014).

Huang, Jerry Shan Shiong. *Mass Communication Research*. n.d. http://mcr.nccu.edu.të/issueArticle.asp?P_No=48&CA_ID=698 (vizituar më 20 prill, 2015).

IREX. *Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias*. Raport vjetor, Uashington: IREX, 2012.

ISHM. *Monitorimi i medias*. Tiranë: Qendra Shqiptare e Monitorimit të medias, 2004.

ISHM. *Vetëcensura dhe censura e butë në median shqiptare*. Vjetor, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2013.

Iufi, Nimet, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (5 shtator, 2013).

KE. *Progres Raport 2014 për Shqipërinë*. Vjetor, Bruksel: Komisioni Evropian, 2014.

KE. *Progres Raporti 2013 për Shqipërinë*. Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore për periudhën 2013-2014, Bruksel: Komisioni Evropian, 2013.

KE. *Raporti i KE për lirinë e medias në Shqipëri*. Raport vjetor, Bruksel: Komisioni Evropian, 2007.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Nr. 23 (2012).

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Nr.10019 (19 dhjetor 2008).

Kore, Blerim. VOA. Maj 03, 2015. <http://www.zeriamerikes.com/content/article/2746653.html> (Vizituar më Maj 03, 2015).

Lani, Remzi. *Gazetaria profesionale dhe vetë-rregullimi : Media e Ballkanit, Lost in Transition?* Tiranë: Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, 2011.

Lefort, Claude. *L'invention démocratique*. Paris: Fayard, 1981.

Ligji për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Nr. 97 (2013).

Ligji për shtypin. Nr. 8239 (3 Shtator 1997).

Londo, Ilda. *Legislation on Media ownership*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2004.

Mane, Bledi. *Gazeta Tema*. 16 Korrik 2011. <http://www.gazetatema.net/ëeb/2011/07/16/15-gazetaret-me-me-influence-te-shqiperise-dhe-pagat-e-tyre/> (vizituar më Maj 04, 2015).

Minga, Denis, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (23 Gusht, 2013).

Muka, Arben, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (11 shtator, 2013).

Musta, Suela, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (3 shtator, 2013).

OSBE. Janar 2004. <http://www.osce.org/sq/fom/34014?download=true> (vizituar më 3maj, 2015).

OSBE. Raport përpara Këshillit të Përhershëm nga Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Raport vjetor, Tiranë: 2013.

Propozim për anëtarë të Bordit të Monitorimit të Medias. Nr. 1795 Prot. (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 23 shkurt, 2015).

Prroni, Fatjon, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (12 shtator, 2013).

Rakipi, Ylli, intervistë nga Ani Ruci. *Shqipëria me gazetari në stanjacion* (3 maj, 2015).

Shkurti, Armir, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (24 Gusht 2013).

Shqip. «Freedom House: Liria e medias në Shqipëri e pjeshme.» *Gazeta Shqip*, 2015: 5.

Shyti, Xhovani. «Gazetaria Lakuriq.» *Gazeta Tema*, 4.05.2015: 9.

Skana, Pranvera. *Statusi socio-profesional i gazetarit shqiptar*. Tiranë: Punim doktoral në Universitetin e Tiranës, 2014.

Tartari, Alban, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (6 shtator, 2013).

Tema. «Gazetarja e ABC Neës denoncon televizionin e vet: kemi dy muaj pa marrë rrogat.» *Gazeta tema*, 04 Maj 2015: 10.

UGSH. *Monografi*. Tiranë: ËESO, 2010.

UGSH, Friedrich Ebert Stiftung, and OSBE. *Praktikat informale të punësimit në median shqiptare*. Tiranë: OSBE, 2012.

Vata, Arben, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensura në redaksi e gazetarit* (8 shtator, 2013).

Vishko, Aida, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (9 shtator, 2013).

Ymeri, Anisa, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensura e gazetarëve në redaksi* (2 shtator, 2013).

Zili, Roland, intervistë nga Ramadan Çipuri. *Vetëcensurimi i gazetarëve në redaksi* (19 gusht, 2013).